

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 12-2019

AUTIZMI, SHKAQET DHE PASOJAT E TIJ

Arta Beqiri

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the **Nursing Commons**



Kolegji UBT
Fakulteti i Infermierisë

AUTIZMI, SHKAQET DHE PASOJAT E TIJ

Shkalla Bachelor

Arta Beqiri

Prishtinë,
Dhjetor / 2019



Koleji UBT
Fakulteti i Infermierisë

Punim Diplome
Viti akademik 2016-2017

Arta Beqiri

AUTIZMI, SHKAQET DHE PASOJAT E TIJ

Mentori: Dr. Sc. Muhamed Tairi

Dhjetor / 2019

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Hyrje: Ky punim hulumtues ka të bëjë me Çrregullimet e Spektrit Autik apo ndryshe i njohur si autizmi. Ky është çrregullim kompleks që prek hapësirat të shumëfishta të zhvillimit duke përfshirëtri fusha kryesore, atë të ndërveprimit shoqëror, komunikimit dhe mënyrës së sjelljes, ky çrregullim prek fëmijët që në lindje, pra ata lindin si të tillë kështu duke u vecuar nga persona te tjerënga shumë aspekte emocional e shoqërore e shumë pak fizike.

Deklarimi i problemit: Autizmi është një çrregullim që prek njerëzit pa marrë parasysh gjinin apo racen. Ky studim do të tregojë se çfarë në të vërtet është autizmi, dhe si ndikon ai tek personat qëjanëtëprekur.

Qëllimi i hulumtimit: Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të tërheqë vëmendjen e njerzve se autizmi nuk është një sëmundje aq më pak ngjitëse por një çrregullim që mund të prek këdo. Me anë të këtij hulumtimi po ashtu do mundohemi të bëjmë ndërgjegjësimin e popullatës që ky çrregullim nuk ëshë sëmundje.

Metodologjia: Gjatë këtij punimi si fillim është përdorur metoda përshkruese, pastaj ajo hulumtuese si pjesa kryesore e punimit, si dhe intervistë e drejtëpërdrejtë.

Konkluzionet: Në këtë hulumtim kemi pasur mundësin të mësojmë mbi autizmin, se çfarë është në të vërtet, se si mund ta luftojmë sa do pak dhe pse preken këta persona po ashtu gjatë hulumtimit jemi njohur edhe me disa raste të disa fëmijëve të prekur me autizëm ku kemi mundur të kuptojm më qartë se nga cka vujanë konkretisht këta fëmijë, po ashtu kemi bërë edhe dallimie mestë dy rasteve ku njëri rezultoi të jetë i prekur shumë rëndë, ndërsa tjetëri kishe simptoma më të lehta.

Ajo çfarë kam konsideruar te nevojshme është rritja e numrit të personave që janë të specializuar për këtë fushë të cilët do të merreshin me autikët. Gjithashtu nga ky hulumtim u arrit në përfundim se autizmi nuk është sëmundje por është një çrregullimi i zhvillimit.

Fjalët kyçe: Autizmi, Çrregullim.

MIRËNJOHJE DHE FALENDËRIME

Një faleminderim dhe mirënjohje të madhe i shkon familjes sime që pa dyshim kanë qenë shtysa dhe mbështetja më e madhe që unë kam arritur të përfundoj me sukses studimet. Shumë e lumtur që arrita të përfundojë edhe këtë qëllim të jetës sime andaj për zemërsishtë falemderuese ndaj gjithë atyre që më përkrahën.

Shpreh mirënjohjen time të thellë dhe faleminderim për ata që më ndihmuan në përpunimin dhe përgaditjen e kësaj teme, mentorin tim, Dr.Sc.Muhamed Tairi që më dha përkrahje dhe më udhëzoi në realizimin e temës sime.

Një faleminderim po ashtu i veçant shkon edhe për qendrën për përkujdesen e fëmijëve “Pema” në Ferizaj, për gjithë ndihmën e ofruar që punimi im të jetë sa më i kompletuar.

I falënderoj të gjithë profesorët dhe kolegët me të cilët kam punuar gjatë këtyre viteve të studimeve. Krejt në fund por jo më të parëndësishme një faleminderim për Dardan Bajramin, i cili ishte një përkrahje e madhe gjatë viteve të studimeve.

“Sukseset më të mëdha nuk ndodhin brenda natës, kërkojnë kohë”

Steve Jobs

PËRMBAJTJA

1. HYRJA	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURES.....	2
2.1. ÇKA ËSHTË AUTIZMI?	2
2.2. Historiku.....	3
2.3. Rreth autizmit.....	4
2.4. Simptomat e autizmit	4
2.5. Zhvillimi i fëmijës autist prejmoshes 0 deri në tetëmbëdhjetëmuajshe	6
2.6. Shkaqet,format dhe pasojat e autizimit	7
2.6.1. Çka e shkakton autizmin.....	7
2.6.2. Klasifikimi i autizmit.....	9
2.6.3. Çrregullimi Aspergerit.....	10
2.6.4. Çrregullimi i Retti-t	10
2.6.5. Çrregullimi disintegruës i fëmijëve	10
2.6.6. Çrregullimi pervaziv i fëmijës	11
2.7. Pasojat	11
2.8. DIAGNOSTIFIKIMI DHE TRAJTIMI I AUTIZMIT	12
2.8.1. Diagnoza.....	12
2.8.2. Trajtimi	14
2.8.3. Metodatat e vlersimit.....	15
2.8.3.1. ABA (Applied Behavior Analysis).....	16
2.8.3.2. TEACCH (Treatment and Education of Autistic and related Communication Children)	16
2.8.3.3. PECS (Picture Exchange Communication System).....	17

2.9.	FAMILJA DHE FËMIJA AUTIK	17
2.9.1.	Qendrat për pëkujdesjen e fëmijëve me autizëm në Kosovë.....	18
3.	DEKLARIMI I PROBLEMIT.....	20
4.	QËLLIMI I PUNIMIT.....	20
4.1.	Objektivi i hulumtimit.....	21
5.	METODOLOGJIA	22
6.	REZULTATET.....	23
7.	DISKUTIME DHE KONKLUSIONE	25
8.	PËRFUNDIMI.....	26
9.	LITERATURA	28

LISTA E FIGURAVE

Figura 1:Simbol (Truri autik).....	2
Figura 2:(Simbol) Karakterizon kompleksitetin e Autizmit	3
Figura 3:(Fëmija i mbyllur në vetëvete)	7
Figura 4:(Fëmija autik duke luajtur)	9

FJALORI I TERMAVE

ASD - Autism spectrum disorde.

PDD-NOS - Pervasive developmental disorder not otherwise specified.

GARS - Gilliam Autism Rating Scale.

QKUK - Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

ADHD - Attention Deficit/ Hyperaktivty Disorder.

ABA - Applied Behavior Analysis

QMF - Qendra Mjekesis Familjare

CDC - Centers for Disease Control and Prevention

GI - Gastrointestinal

1. HYRJA

Rëndësia e këtij punimi mund të mbështetet në disa pika, të cilat po i rëndisim si më poshtë:

Së pari, përmes një studimi të tillë do të kemi një pasqyrim të asaj se çfarë në të vërtetë është autizmi, pastaj se cilat janë shenjat e hershme të autizmit, nga çka shkaktohet ai, cila është ndihma që duhet ofruar këtyre personave nga familja dhe shoqëria.

Së dyti duke analizuar këto elemente, do të kemi mundësi të shohim se cili është roli i stafit mjekësor në qasjen dhe ofrimin e ndihmave dhe këshillave ndaj fëmijve më autizëm.

Gjithashtu, qëllimi tjetër është hulumtimi i gjendjes së personave me autizëm e konkretisht fëmijëve autik. Përmes hulumtimit të problematikave me të cilat përballet kjo kategori e shoqërisë, do të tregohet realiteti të cilin e përjetojnë këta fëmijë .

2. SHQYRTIMI I LITERATURES

2.1. ÇKA ËSHTË AUTIZMI?

Fjala « Autist » vjen nga greqishtja « αυτοσ » që do të thotë «vetvetja », paraqet njërën ndër dukuritë psikofizike, shëndetsore e sociale e cila i godet fëmijët në moshë të hershme.

Autizmi është një çrregullim që shfaqet në fëmirijnë e hershme dhe prek tri fusha kryesore të zhvillimi, atë të ndërveprimit shoqëror, komunikimit, dhe mënyrës së sjelljes.

Çrregullimet e Spektrit Autik karakterizohen nga nivele të ndryshme:

- të dëmtimit të komunikimit verbal
- të dëmtimit të aftësive dhe integritimit social
- të sjelljeve, interesave dhe aktiviteteve stereotipike ose përsëritëse.

Autizmi është një paaftësi zhvillimore gjatë gjithë jetës që ndikon në atë se si njerëzit perceptojnë botën dhe bashkëveprojnë me të tjerët.

Njerëzit autik e shohin, dëgjojnë dhe ndiejnë botën ndryshe nga njerëzit e tjerë. Nëse jeni autik, jeni autik për jetë, autizmi nuk është sëmundje por as nuk mund të shërohet.



Figura 1: Simbol (Truri autik)

Foto e marrë nga Interneti

2.2. Historiku

Termi autizëm u përdor për herë të parë nga psikiatri Eugen Bleuler në 1908, ai e përdori atë për të përshkruar një pacient skizofren, i cili ishte tërhequr në botën e tij, duke nënkuptuar adhurimin e vetvetes.

Më 1943 Leo Kanner, psikopediatër amerikan e përshkroi autizmin si një çrregullim afektiv të komunikimit dhe të mardhënieve me të tjerët dhe që prek inteligjencën. Sipas tij bëhet fjalë për një çrregullim të lindur për të cilin prindërit nuk mund të gjykoreshi përgjegjës. Megjithatë ai gjente tek ata diçka që e quante të ftohtë dhe të ashpër.

Ndërsa në vitin 1944, një psikiatër austriak Hans Asperger, përshkruante disa fëmijë si të prekur nga psikopatia autistike, dhe që karakterizoheshin gjithashtu nga sjellje të çuditshme dhe nivel inteligjence që mund të shkonte nga debiliteti deri në gjeni. Po ashtu sipas tij fëmijët e kësaj kategorie e zhvillojnë mirë gjuhë dhe në momentin e duhur, por nuk e vënë atë në shërbim të komunikimit dhe zhvillimit të tyre social.

Bruno Bettelheim në vitin 1950, e krahasoi sjelljen e autikut me të burgosurit në kampin e përqëndrimit nazist, të cilët ishin marrë me zor dhe ishin vendosur në mjedise armiqësore.

Që prej vitit 1980, klasifikimi ndërkombëtar i sindromave autistike si çrregullim pervaziv i zhvillimit çoi në braktisjen e teorisë psikodinamike të autizmit dhe të konceptit “psikozë artistike” në pothuajse gjithë vendet e botës, me pak përjashtime në Francë e disa vende të Amerikës Latine, ku kulturat psikoanlitike ushtron ndikim të madh në praktikën psikiatrike.

(Saqellari,2017)



Figura 2:(Simbol) Karakterizon kompleksitet e Autizmit

Foto e marrë nga Interneti

2.3.Rreth autizmit

Autizmi është një paaftësi komplekse e zhvillimit të fëmijëve që zakonisht shfaqet mes moshës 1-3 vjet. Është një çrregullim neurologjik qëndron në funksionimin e trurit. Ky çrregullim paraqitet katër herë më shumë tek gjinia mashkullore sesa tek ajo femërore. Duhet të kemi parasysh se ky çrregullim nuk ka lidhje me racën, etninë apo shoqërinë në përgjithësi, aq më pak të niveleve arsimore apo edhe të ardhurat e familjes.¹

Në vitin 2018 Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në Amerikë (CDC), përcaktoi që afërsisht 1 në 59 fëmijë diagnostikohen me (ASD) autizëm, 1 në 37 djem dhe 1 në 151 vajza.

Personat me autizëm nuk dallojnë nga pamja fizike nga personat e tjerë, por vetëm kanë një natyrë më ndryshe se që është e shprehur zakonisht mes njerëzve!. Rreth 1% e popullsisë në botë kanë çrregullim të spektrit autik. (CDC, 2014).

Prevalenca në Shtetet e Bashkuara vlerësohet në 1 në 59 lindje. (CDC, 2018) Ndërsa në Angli 1% e popullsisë së rritur kanë çrregullim të spektrit autik.

Autizmi prek të gjitha grupet etnike dhe socio-ekonomike. Grupet e pakicave kanë tendencë të diagnostikohen më vonë dhe më rrallë, kjo ndoshta për shkak të rrethanave të tjera të cilat nuk lidhen me autizmin.

Por gjithmone duhet të kemi parasysh që ndërhyrja e hershme ofron mundësinë më të mirë për të mbështetur zhvillimin e shëndetshëm dhe për të arritur që të përmirësohet sado pak fëmija autik.²

Në botë edhe Autizmi shënon ditën botërore e cila është më 2 prill, dhe se pothuajse në gjitha vendet muaji prill njihet si muaji i autizmit, me ç rast realizohen edhe shume fushata vetëdijësuese dhe aktivitete të tjera për të informuar njerëzit për autizmin si dhe për të mbështetur të gjitha ata të cilët janë të prekur me ASD.

2.4. Simptomat e autizmit

Autizmi shfaqet qysh në fëmijërinë e hershme, zakonisht midis moshës dy-trevjeçar dhe kështu prek tri fusha kryesore të zhvillimit:

<http://www.autizmi-ks.net/>

<https://www.autismspeaks.org/autism-facts-and-figures>

1. *Ndërveprimit shoqëror*
2. *Komunikim*
3. *Mënyrën e sjelljes*

Autizmi nuk përcaktohet specifikisht nga disa simptoma të caktuara, por janë një grumbull simptomash me të cilat mund të evidentohet nëse një fëmijë mund të diagnostifikohet si autik.

Simptomat nganjëher mund të mos jenë edhe shumë dalluese në fëmijë e hershme mirëpo një sy i vëmendshëm mund ti vërejë ato simptoma edhe gjatë vitit të parë të jetës së fëmijës.

Tek fëmijët autik ka një kontakt të dobët me sy dhe një mos reagim ndaj zërit njerëzor, po ashtu mund edhe të mungojë e qara e parë, buzëqeshja, gënjatjet, loja.

Simptomat thelbësore të autizmit janë sfidat e komunikimit shoqëror ,sjelljet të kufizuara dhe të përsëritura. Po ashtu fëmijët dhe të rriturit me autizëm kanë vështirësi në komunikimin verbal dhe ate jo-verbal. Pra ata nuk mund ta kuptojnë ose përdorin siç duhet:

- Gjuhën e folur
- Kontakti me sy
- Shprehjet e fytyrës
- Tonin e zërit
- Pasataj kanë mungesë interesimi për marrëdhënie me të tjerët.
- Fiksion i vazhdueshëm në objekte të ndryshme.
- Mungesa e lojërave spontane.

Ashu siç e kemi përmendur në fillim që autikët kanë dëmtime në tri fusha dhe se secila prej këtyre mund të jetë e dëmtuar lehtë a rëndë, duke shkaktuar paaftësi të niveleve nga më të lehtë tek më të rënda dhe se për shkak të paqarta fëmijët me autizëm shfaqin epilepsi në 20-30 % të rasteve, sidomos kur mbërrijnë në moshë madhore.

Duhet kontrolluar vazhdimisht fëmijën nëse i ka këto shenja, pasi mjekët dhe terapeutët pajtohen që sa më herët të identifikohen simptomat e autizmit është më mirë për shkak të trajtimit të duhur me kohë dhe që të arrihet që sado pak ti zbusin këto simptoma. Fëmijët autik njihen për talentet të

veçanta që mund t'i kenë dhe nëse autizmi identifikohet në fazat e hershme, bashkë me trajtimin dhe shkollimin e duhur do të ndihmonte në zhvillimin e aftësive të tyre.

2.5. Zhvillimi i fëmijës autist prejmoshes 0 deri në tetëmbëdhjetëmuajshe

Zhvillimi i fëmijës autist dallon nga zhvillimi normal i fëmijës, janë disa shenja të cilat bëhen daluese t'k fëmijët autk dhe se vit pas viti këtyre shenjave u shtohen edhe më shumë shenja, mirëpo gjithmonë duhet të kemi parasysh që që jotë gjithë fëmijët reagojnë njësoj disa reagojn më shpejtë disa më ngadalë.

Si pikë e parëshë shoqërizimi

1. Foshnja rri në krahët e personit adult (si pa jetë, si një kukull)
 - Vonohet shfaqja e buzëqeshjes, apo buzëqesh shume pak
 - Shmang vështrimin e tjetrit
 - Nuk i shtrin krahët drejt personitqë e nxit me gjeste e fjalë për ta marrë hopa.
 - Është e vështirë ta qetësosh
 - Parapëlqen vetminë

2. Komunikimi
 - mungesë ekomunikimit verbal
 - mungesë e gjesteve për të komunikuar
 - mungesë e shprehjes trupore dhe mimikës.

3. Sjelljet e quditshme
 - përsëritje të shpeshta të përplasjeve së duarve
 - pasivitet
 - plogështi
 - humbje interesi për lodrat
 - indiferencë ndaj tjetrit




Figura 3(Fëmijë i mbyllur në vetëvete)

Foto e marrë nga Interneti

Ndërsa më poshtë do ti paraqesim si është zhvillimi normal i një fëmije, dim që foshnja që në javën e parë kërkon të hyjë në kontakt me të rriturin. Ai është i ndjeshëm ndaj përkledheljes që i japime fjalë e me gjeste.

Njëmuajsh foshnja reagon ndaj zhurmave dhe ndjek me sy një lodër me shumë ngjyra ,fikëson me sy fëtyrat e prindërve

Dy-tre muajsh luan me duart dhe kthen kokënpër të ndjekur një objekt.Gjallërohet kur sheh biberonin.

Katër –pesëmuajsh kërkon të marrë lodrën që i tundim para fëtyrës.I përgjigjet zërit njerëzor duke vokalizuar,qesh me të madhe dhe kthen kokën kur e thërrasim në emër.

(Saqellari,2017)

2.6. Shkaqet,format dhe pasojat e autizimit

2.6.1. Çka e shkakton autizmin

Edhe pse ka vite që autizmi ekziston dhe është identifikuar, ende nuk janë gjetur shkaktarët e saktë të tij. Pavarësisht përpjekjeve të mjekësisë, sidomos asaj amerikane, nuk ka diçka definitive përveç hipotezave. Hipotezat e deri tanishme është se shkaktarët e autizmit, janë baza gjenetike si dhe ndryshimet e trurit në fazën e hershme.

Edhe pse ende nuk dihet një shkaktar i vetëm, përgjithësisht pranohet se ajo është shkaktuar nga anomalitë dhe mosfunksionimi i mirë i trurit. Në anën tjetër studiuesit po hetojnë mundësinë që në kushte të caktuara, një grup gjenesh të paqëndrueshme mund të ndërhyjnë në zhvillimin e trurit, duke rezultuar në autizëm si dhe po hetojnë problemet gjatë shtatëzënisisë ose lindjes, si faktorë të mundshëm, por përveq këtyre faktorëve ata kanë përfshirë edhe disa faktorë mjedisorë siç mund të jenë infeksionet virale, pabarazitë metabolike dhe ekspozimi ndaj kimikateve.³

Pra si shkaktar të mundshëm që kontribuojnë për ASD, përmenden gjenet dhe mjedisi si dhe shkaqet tjera biologjike të kombinuara së bashku. Por disa autorë mbështesin iden se vetëm gjenet janë një nga shkaqet kryesore ose më mirë të themi kontribues i madh për ASD. Sidoqoftë, lidhjet midis mutacioneve gjenetike dhe autizmit është komplekse dhe se jo të gjithë njerëzit me autizëm kanë ndryshime në gjene, siç edhe u cekë më lartë edhe faktorët biologjik përveç gjeneve mund të kontribuojnë në shfaqjen e ASD.

Si për shembull:

- Probleme me lidhjet e trurit
- Problemet me rritjen më të madhe në zona të caktuara të trurit.
- Probleme me metabolizëm
- Probleme me sistemin imunitar të trupit, i cili e mbron nga infeksionet.

Si shkaktar tjerë të mundshëm dhe që mund të rrisin rrezikun për shfaqjen e autizmit hyn edhe mosha e vjetër e prindërve, shtatëzani dhe komplikimet e lindjes (për shembull lindja para kohe, pesha e ulët e foshnjës që lind, shtatëzania e shumëfishtë (binjakë), pastaj edhe shtatëzania me hapsirë më pak se një vit larg.

Por prap se prap vështirësia e identifikimit të shkaktarëve të autizmit, vjen si pasojë e kompleksiteti të saj.



Figura 4:(Fëmija autik duke luajtur)

Foto e marrë nga Interneti

2.6.2. Klasifikimi i autizmit

Duhet të dimë se jo të gjithë personat të cilët janë të prekur me autizem kane manifestime të njejta të simptomave, në fakt asnjë fëmijë i cili diagnostifikohet si i prekur me autism nuk është i njejtë me fëmijën tjetër, pasi secili fëmijë mund të veçohet nga sjellje të ndryshme në vartësi nga çrregullimi nëse është më i rëndë apo më lehtë.

Pra autizmi është pjesë e pesë çrregullimeve të përhapura të zhvillimit:

- *Çrregullimi Autistik*
- *Çrregullimi i Aspergerit*
- *Çrregullimi i Rett-it*
- *Çrregullimi Disintegrues i Fëmijëve*
- *Çrregullimi Pervaziv i Fëmijëve*

2.6.3. Çrregullimi Aspergerit

Sindroma e Asperger (AS), është një grup çrregullimesh neurologjike të njohura si çrregullime të spektrit të autizmit (ASD).

Njerëzit me AS shfaqin tre simptoma kryesore:

- *Kanë vështirësi në bashkëveprimin shoqëror*
- *Kanë sjellje të përsëritura*
- *Përqëndërohen në gjëra të njejtë*

Ajo që e dallon çrregullimin e Aspergerit nga autizmi klasik janë simptomat e tij më pak të rënda dhe mungesa e vonësive në gjuhë. Fëmijët me çrregullimet e Aspergerit mund të preken butësisht, dhe ata shpesh kanë aftësi të mira gjuhësore dhe njohëse.

Duhet të kemi parasysh që për një vëzhgues të pa trajnuar mirë, një fëmijë me çrregullimin e Asperger-it thjesht mund ti duket si një fëmijë neurotipik që sillet ndryshe, dhe të gaboj në diagnozën e tij.

2.6.4. Çrregullimi i Reti-t

Karakteristika thelbësore e çrregullimit të Reti-t është zhvillimi i deficiteve të shumta specifike pas një periudhe të funksionimit normal pas lindjes.

Në vitet e para humbin interesin për mjedisin shoqëror,po ashtu kanë çrregullim në zhvillimin e gjuhës.

Një çrregullim progresive i cili deri më tani, ka ndodhur vetëm tek vajzat. Reti-i, Karakterizohet me periudha të zhvillimit normal dhe pastaj humbjen e aftësive të fituara më parë, posaqërisht humbjen e përdorimit të duarve të zëvendësuar me lëvizjetë përsëritura të duarve duke filluar në moshën 1-4 vjeç.

2.6.5. Çrregullimi disintegrues i fëmijëve

Tipar kryesor i çrregullimit disintegrative (jo integrues), i fëmijës është një regresion i theksuar në fusha të shumta të funksionimit pas një periudhe prej të paktën dy vitesh të një zhvillimi të dukshëm normal. Pas dy viteve të para të jetës, fëmija ka një humbje klinike të rëndësishme të aftësive të fituara më parë në të paktën dy nga fushat e mëposhtme:

- gjuhën shprehëse

- aftësi shoqërore ose sjellje adaptive
- kontrolli i zorrëve ose fshikëzës
- aftësin lojës ose motorike.
- Individët me këtë çrregullim shfaqin deficitet sociale dhe komunikuese.

Pra këta fëmijë karakterizohet me zhvillimi normal për të paktën 2 vitet e para, dhe me pas me humbjen e këtyre aftësive të fituara më parë.

2.6.6. Çrregullimi pervaziv i fëmijës

Karakteristikat thelbësore të PDD-NOS (çrregullimit pervaziv) janë dëmtime të rënda dhe të përhapura në zhvillimin e ndërveprimit shoqëror reciprok ose aftësive të komunikimit verbal dhe joverbal në sjellje, interesat dhe aktivitetet.

2.7. Pasojat

Dimë që autizmi nuk shërohet por që nëse zbulohet më kohë dhe intervenohet me kohë, pasojat pa diskutim do të jenë më të vogla dhe më të lehta si për fëmijën ashtu edhe për prindërit e tij.

Një vëmendje e kujdesshme e prindit në bashkëveprim me fëmijën do ti hapë rrugë një vlersimi të hershëm. *Por pse është i rëndësishëm vlerësim i hershëm apo diagnostifikimi sa më herët?*

Në rrathtë të parë e ndihmon fëmijën, pasi autizmi përballohet me një ndërhyrje të hershme, kjo ndërhyrje në kohë ju “pret” rrugë shumë çrregullimeve të sjelljes, si dhe është një ndihmes e madh për prindërit të kuptojnë fëmijën e tyre dhe të jenë sa më komunikues në mënyrë që të ballafaqohen më lehtë me pasojat. Sa më parë që të krijohet një plan gjithëpërfshirës trajtimi për një fëmijë që ka autizëm aq më mirë ai ose ajo është në gjendje të mësojë aftësitë e nevojshme për të udhëhequr një jetë riprodhuese. Meqenëse nganjëhere simptomat e autizmit mund të imitojnë çrregullime të tjera ose mund të jenë mjaft të vogla që një prind ose kujdestar të i vërejë, diagnoza dhe trajtimi i autizmit mund të vonohet dhe të mos mund të arritet që sado pak të interventohet në kohë, pasi edhe efektet apo pasojat afatgjate të autizmit mund të përfshijnë probleme të ndryshme si për shembull:

- *Mosmarrëveshje familjare*
- *Vështirësi në formimin dhe mbajtjen e miqësive*

- *Vështirësitë që lidhen dhe empatizojnë me njerëzit e tjerë*
- *Disa mund të kenë probleme të jetojnë në mënyrë të pavarur, si dhe probleme me gjumin, dhe ankthet etj.*

2.8. Diagnostifikimi dhe trajtimi i autizmit

2.8.1. Diagnoza

Kur prindërit apo kujdestarët janë të shqetësuar se fëmija i tyre nuk po ndjek një zhvillim normal ata i drejtohen ekspertëve, përfshirë psikologë, edukatorë dhe profesionistë mjekësorë, për një diagnozë të saktë. Ata në rrahë të parë ju drejtohen një pediari për fëmijë i cili zakonisht, me rastin e kontrollimit preliminar merr parasysh historinë e zhvillimit dhe kontrollimin fizik të fëmijës. Nëse ekziston rreziku, diagnoza dhe vlerësimi i mëtutjeshëm bëhen me ndihmën e ekspertëve për ASD.

Një ekip i specialistëve të cilët mund të përfshihen në diagnostikimin e fëmijës me autizëm mund të jenë:

- *Psikologët e fëmijëve*
- *Psikiatrët e fëmijëve*
- *Logopedë*
- *Pediatër të zhvillimit*
- *Neurologët pediatrikë*
- *Terapistë fizikë*
- *Mësuesit e arsimit special*

Diagnostifikimi i çrregullimit të spektrit të autizmit nuk është një proces i shkurtër, për të cilin ekziston një zgjidhje pasi nuk ka asnjë test të vetëm mjekësor që mund ta diagnostikojë përfundimisht atë.

Përkundrazi, për të identifikuar me saktësi problemin e fëmijës, vlerësime dhe teste të shumta janë shumë të nevojshme. Diagnoza e autizmit bazohet kryesisht në sjelljen e fëmijës aktualisht pasi nuk ka ndonjë test mjekësor (për shembull analizë gjaku, rreze x etj.) që do të ndihmonte në diagnostikimin e autizmit, në shumicën e rasteve simptomat e autizmit janë të matshme me disa teste vlerësimi që në moshën 18 muajshe.

Një diagnozë e konfirmuar e autizmit mund të vendoset rreth moshës 2 vjeç, pavarësisht se në praktikë është rreth dy vjeç e gjysëm-3 pikërisht atëherë kur problemet me të folurin bëhen më të dukshme.

Një vlerësim për të zbuluar çrregullimin e spektrit të autizmit përfshinë disa hapa shumë të rëndësishme ku përfshihen prindërit dhe specialistët e fushës përkatëse.

1. **Intervistë me prindërit** - në fazën e parë të vlerësimit diagnostik, mjeku kërkon informacione mbi historin mjekësore, zhvillimore dhe sjelljet e fëmijës në përgjithësi. Po ashtu këtu mirren edhe të dhënat apo informacione shtesë për historinë e shëndetit fizik dhe mendor të familjes.
2. **Vlerësimi fizik**- vlerësimi mejkësor përfshin edhe një ekzaminim të përgjithshëm fizik, një provim neurologjikë, pastaj edhe teste laboratorike dhe një testim gjenetik.
3. **Testi i dëgjimit** - meqenëse problemet e dëgjimit mund të rezultojnë në vonesa sociale dhe gjuhësore, ato duhet të përjashtohen para se të mund të diagnostikohet një çrregullim i spektrit të autizmit. Fëmija duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi zyrtar audiologjik ku ai ose ajo testohet për çdo dëmtim të dëgjimit.
4. **Vëzhgimi** - specialistët e zhvillimit duhet të vëzhgojnë fëmijën në një sërë ambientesh për sjellje të pazakonta që lidhen me këtë çrregullim. Ata shikojnë fëmijën për derisa luan edhe se si bashkëvepron me të tjerët.

Edhe sipas Shoqatës Psikologjike Amerikane e cila ka publikuar manualin diagnostik dhe statistikor më 2013 udhëzon mjekët që të drejtohen sipas simptomave apo etapave që cekëm më lartë, pra historin e zhvillimit dhe informacionet nga prindërit apo kujdestarët , pastaj një përcaktim fizik e arsimor, por të gjitha këto të dhëna të mbledhura duhet të rishikohen përsëri nga një ekip profesionistësh të kualifikuar kur duam të japim një diagnozë sa më të saktë.

Ështëe rëndësishme për të kuptuar se pavarësisht nga diagnoza, fëmijët mund të mësojnë dhe të funksionojë në mënyrë produktive dhe të përfitoj nga arsimimi dhe mjekimin/trajtimi i duhur. Identifikimi i hershme mund të ndryshojë jetë! Autizmi nuk është i shërueshëm, por mund të mjekohet. Studimet tregojnë se diagnoza e hershme dhe ndërhyrjet klinike mund të çojnë në rezultate të një përmirësimi të dukshëm.⁴Në Kosovë, sipas informatave të marra nga Klinika e

Psikiatriisë për Fëmijë dhe Adoleshentë, nuk ka ndonjë instrument të përkthyer dhe të adaptuar në gjuhën shqipe ku do të mundet të bazoheshim në të, megjithëse diagnoza e autizmit bëhet kryesisht me anë të GARS (Shkalla Ranguese e Gilliam për Autizëm) . GARS, është një metodë vlerësimi për individët nga mosha 3 deri 22 të cilët kanë problem të rënda të sjelljes që mund të jenë tregues i autizmit. Deri më tani në Kosovë, në nivel qeveritar ekzistojnë dy shërbime bazë për autizmin:

1. Klinika e Psikiatriisë për Fëmijë dhe Adoleshentë në kuadër të së cilës ndër tjera ofrohet edhe diagnostikimi i fëmijëve me autizëm dhe,
2. Klasa e bashkangjitur për fëmijët me autizëm në shkollën fillore “Ismail Qemali” në Prishtinë, e cila është shkollë e rregullt. Në këtë klasë ofrohet integrim i fëmijëve me nevoja të veçanta duke përfshirë edhe fëmijët me autizëm.

Në institucionet shëndetësore të sektorit publik shërbimet ofrohen pa pagesë siç janë shërbimet diagnostikuese për fëmijë që ofrohen në QKUK. Megjithatë, në këtë sektor mungojnë shërbimet direkte ditore për fëmijët me autizëm.

Ndërsa sa i përket statistikave se sa është numri i persoave me autizëm në Kosovë nuk mund të dihet saktë për shkak se nuk janë bërë hulumtime që do të tregonte numrin e saktë, mirpo derisa numri i personave më autizëm nuk dihet edhe për shkak të stereotipeve të tjera, Kosova po vazhdon të ketë mungesë të kuadrove të specializuar të cilët do t’i trajtojnë dhe mbështesin këta fëmijë.

2.8.2. Trajtimi

Trajtimi apo mjekimii fëmijëve me autizëm ka për qëllim përmirësimin e simptomave dhe arritjes së një mirëqenje sa më të mirë për personin autik.

Siç e kemi cekur edhe më lart se ilaç për të shëruar autizmin nuk ka, këtu i gjithë “trajtimi” lirisht mund të themi se bie në rolin e familjes e më saktë ai prindërve, dhe kujdestarve të tjerë.

Duke pasur parasysh që prindërit janë afër fëmijës që nga lindja dhe janë dëshmitarë të vazhdimësisë së zhvillimit të tyre ata janë në gjendje të shohin nevojat, vështëritë ngecjet që fëmija i tyre ka.

Si pjesë kryesore e trajtimit është komunikimi në nivelin e kërkuar dhe në moshën sa më të hershme e fëmijës.

Nëse në të kaluarën fëmijët e prekur me autizëm ishin të burgosurit e sektorit të psikiatris pa asnjë prespektivë edukim, integrimi social dhe profesional, sot falë shoqatave të ndryshme ata janë

plotësisht të trajtueshëm në aspektin edukativ, social dhe shkollor, të kemi parasysh gjithmonë qëkemi ende vende në botë ku kjo nuk është që zbatohet aq sa duhet dhe se sa kanë nevojë këta fëmijë.

Personat me autizëm kanë nevoja të ndryshme dhe të vecanta, kështu që gjetja e opsioneve më të mira të trajtimit duhet të jetë gjithmonë individuale.

Qëllimi nuk është për të kurrë autizmin, por për të ndihmuar personin të fitoj aftësi dhe të ketë një shanc më të mirë në jetë. Një person me autizëm do të jetë një person autik gjatë gjithë jetës së tij. Kjo është një zonë ku ka shumë pretendime të trajtimit të pambështetur, dhe mund të jenë shumë tëndërlikuar. Por disa opsione të provuara dhe të vërtetuara mund të fillojnë një rrugë pozitive dhe ti mundësojnë një jetë më të mirë personave autik.

Fëmija autik pas diagnostifikimit të saktë fillon më një trajnim varësisht nga gjendja edhe nevojat e tij. Si pikë e parështetë terapia e të folurit, pastaj ajo profesionale, pastaj fizike si dhe ajo e aftësive sociale.

Por përpos këtyre terapive kemi dhe metodave edukative dhe të sjelljes të cilat dita ditës po përdoren edhe më shumë për fëmijët autik. Këto terapi kanë për qëllim pakësimin e mangësive dhe sjelljeve jo normale që lidhen me autizmin si dhe për të rritur cilësinë e jetës dhe pavarësinë funksionale të tyre.

2.8.3. Metodatat e vlersimit

Trajtimindahet në dy kategori kryesore: ndërhyrje arsimore dhe të menaxhimit mjekësore.

Disa prej metodat të ndërhyrjeve janë:

- ***ABA- (Applied Behavior Analysis) Analize e sjelljeve të aplikuara***
- ***TEACCH (Treatment and Education of Autistic and related Communication Children)***
- ***PECS-(Picture Exchange Communication System) Sistem komunikimi me anë të këmbimit të fotove***
- ***Floortime/DIR (Koha për dysheme) Terapi intensive në dysheme, për te përmirësuar ndërveprimet sociale!***
- ***Music therapy (Terapi muzikore)***
- ***Sensory intergration (Integrim ndijor/ ndjesive/ndjenjave)***

- *Dietë- Dietat e ndryshme*
- *Medications-Medikamente*

Tani do të flasim për disa nga terapit në mënyrë që të njohim më mir mënyrën e realizimit të terapisë edhepërmbajtjes së saj:

2.8.3.1. ABA (Applied Behavior Analysis)

ABA (Applied Behavior Analysis)- apo në shqip analizë e sjelljeve të aplikuar , kjo metodë hapat e para i ka në Amerikë nga doktori Ivar Lovaas. Bazat e ndërhyrjes së saj është ndryshimi i sjelljes me anë të të nxëniet, të ushtruar shumë herë intensivisht dhe me motivim. Programi që sot përdoret për këtë terapi është miratuar në vitin 1987 dhe se qëllimi parësor i terapisë ABA është integrimi i fëmijëve në çerdhe, dhe si metodë mbështetet apo orientohet në tri elemente kryesorë

- Mbështetje, (ndihma që i jepet fëmijës për të kryer aktivitetin)
- Përgjigjja dhe sjellja e fëmijës gjatë kryerjes së aktivitetit
- Reagimi i terapistit ndaj kësaj përgjigjeje dhe kësaj lloji sjelljeje.

Përgjithësisht kjo metodë na tregon se sa e rëndësishme është terapia individuale si edhe përsëritja e aktiviteteve të cilat janë të dobishme për fëmijën në përmirësim aftësive përqëndruese të fëmijës si edhe atyre verbale.

Metoda ABA, ka një kosto të lartë por ka dhe një intensitet të madh në kohës, diku (30-40) orë në javë.

2.8.3.2. TEACCH (Treatment and Education of Autistic and related Communication Children)

Një terapi tjetër po ashtu shumë e rëndësishme në zhvillimin e fëmijës autik është edhe TEACCH ((Treatment and Education of Autistic and related Communication Children).

TEACCH është një nga metodat më të përhapura në botë, dhe për qëllim kryesor ka aftësimin e fëmijës për tu bërë i zoti i vetvetës. Po ashtu kjo metodë ka për bazë autonomin e individitë kështu duke i ofruar fëmijës mbështetje dhe ndihmë ndërkohëme kalimin e kohës duke e zvogëluar këtë

ndihmë kur shohim rritjen e aftësisë së fëmijës. Si metodë përfshinë prindërit , edukatorët dhe të gjithë rrethin shoqërorë të fëmijës autik, dhe se për dallim nga metoda ABA, kjo metodë nuk është shumë e kushtueshme.

2.8.3.3. PECS (Picture Exchange Communication System)

Metodë tjetër e cila hynë në metodat për trajtimin e Autizmit është edhe PECS (Picture Exchange Communication System) apo në shqip Sistem komunikimi me anë të këmbimit të fotove.

Fillimisht kjo metodë kërkon praninë e dy terapesitëve me një fëmijë. Një shembull gjatë manovrimit të një seance kur një fëmijë kërkon një send, një nga terapistët e shtyn atë të marrë imazhin e tij dhe tjetri e nxitë të ia jap. Dhe se me kalimin e kohës sendet me imazhet e tyre me të cilët fëmija luan apo kryen aktivitetet e caktuara, shtohen gjithmonë e më shumë dhe kështu në këtë mënyrë nxitet fëmija që të zgjedhë midis tyre ti mësoj ato dhe të angazhohet sa më shumë në aktivitet.

Pra PECS, përdor shumë foto e objekte, veshje, ushqime për shkëmbimin e imazheve me fëmijët. Si metodë fillimisht është përdorur në Amerikën Latine kryesisht vetëm për fëmijët autik, mirëpo sot gjenë përdorim edhe për fëmijët që kanë vështësi apo pamundësi në komunikimin verbal.

2.9. Familja dhe fëmija autik

Të bërit prindër të një fëmije është kënaqësi dhe ndjesi e bukur , kështu duke rritur dashurin e prindërve për fëmijën dhe ides se si dotë jetë dhe si do të rritet në të ardhmen. Nga gjithë kjo jo gjithmonë të gjitha rrethanat janë të kënaqshme dhe se mund të përballohem me gjërat të cilat ndoshta as nuk i kemi imagjinuar më parë, të lindurit e një fëmije autik.

Fëmija autik, para se të jetë i tillë është njeri, e rëndësishme është ta duam atë dhe jo ta mëshirojmë. Kur një fëmijë është i diagnozifikuar me autizmit është një përvojë mjaft e rëndë për prindërit dhe gjithë familjen e tij. Edhe pse mund të preket një fëmijë i vetëm, nga ky çrregullim ndikonnë tërë familjen si në aspektin emocional, shëndetësor dhe social tek prindërit. Gjithashtu, ka ndikim mbi marrëdhënien me anëtarët e tjerë të familjes, mes vëllezërve dhe motrave. Rritja e një fëmije me autizëm mund të jetë një përvojë e vështirë për prindërit dhe familjen, rritjen

e stresit tek prindërit, pastaj në disa raste tensionit të konsiderueshëm financiar si dhe vet presionit se çfarë hapa të ndërmar për fëmijën si dhe për mirëqenie e familjes. Por duhet të kemi parasysh që i gjithë ky jostabilitet, stres apo në disa raste dhe depression dhe mos rahatit ndikonë nëçfardo forme edhe tek fëmija autik, kështu negativisht duke minimizuar efektet pozitive që mund të ketë fëmija apo mund të ketë fituar apo mësuar.

Roli i familjes në këtë rast i prindërve në përmirësimin e gjendjes së fëmijës qysh në fillimet e diagnostifikimit të hershëm mund të shpije në një përmirësim shumë të mirë të fëmijës, por ndikim të madh po ashtu përpos prindërve kanë edhe anëtarët e tjerë të familjes në raste nëse fëmija autik ka vëlla apo motër shoqërizimi i tyre mes vete është po ashtu i një rëndësie të madhe dhe të vecantë, si dhe mund të ndikojnë në rritjen e aktiviteteve të fëmijës si dhe socializimin e tij.

Të kesh një fëmijë autik nënkupton të ndihmosh atë në ndërveprim shoqëror, të keni kujdes në mënyrën se si komunikoni me ta, dhe të jeni sa më mbështetës. Por i gjithëmundi dhe përpjekja nga prindërit për personat autik, këta jo gjithmonë e marrin edhe mbështetjen e rrethit dhe shoqërisë pasi edhe kjo është e rëndësishme duke pasur parasysh paragjykimet që ju bëhen këtyre prindërve që kanë fëmijëtë tillë e aq më tepër paragjykimi direkt për vetë këta fëmijë. Në Kosovë ende ekzistojnë paragjykimet të lloj llojshme që iu bëhen këtyrë personave. Paragjykimet vijnë si pasojë e mungesës së informimit për këtë kategori si dhe pasojë tjetër është edhe mungesa e specialistëve për autizëm. Shpesh herë personat autik nuk pranohen as edhe nga vetë familja si pasojë e kësaj ata nuk regjistrohen as në shkollë, as në ndonjë institucion përkatës. Përgjithësisht fëmija dhe prindërit kanë nevojë për mbështetje, ngrohtësi e dije, sepse bëhet fjalë për një rrugë të gjatë e të mundimshme.

2.9.1. Qendrat për përkujdesjen e fëmijëve me autizëm në Kosovë

Në Kosovë ekzistojnë disa shoqata dhe organizata që mirren me personat të cilat kanë nevojë të vecanta përfshirë këtu edhe ata me autizëm. Një ndërto e cila mirren konkretisht me fëmijët autik është organizata jo qeveritare “Autizmi”, e cila ka për qëllim zhvillimin eshkatësive dhe potencialeve të fëmijëve me autizëm, integrimin e tyre në shoqëri dhe rritjen e vetëdijes në nivel qeveritar dhe jo qeveritar lidhur me autizmin. Kjo qendër e cila me gjendet në Prishtinë, ka edhe degëte saja në vende tjera në Kosovë si Prizren, Suharekë dhe Pejë. Kjo qendër e vazhdon të

mbijetoj nga vetfinancim, prindërit e fëmijëve autik, shoqëria dhe vullnetarë e ndryshëm. Kjo organizatë ofron shërbime terapeutike në këto fusha:

- Psikoterapi (ABA Terapi)
- Logopedi
- Ergoterapi

Po ashtu në vendin tonë ekzistonte dhe Asocacionin Nacional i Autizmit i cili është themeluar në janar të vitit 2012, e cila për mision ka ofrimin e shërbimeve dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve për autizmin në Kosovë. Për fëmijët me nevojë të veçanta po ashtu që nga viti 2013 është themeluar edhe Qendra e kujdesit ditor “Pema” organizatë jo qeveritare me qendër në Prishtinë por edhe nëpër disa komuna të Kosovës, si Pejë, Ferizaj, Prizren, Gjilan.

Kjo qendër ofron shërbime psikosociale dhe rehabilituese e këshilluese për të gjithë fëmijët deri në moshën 18 vjeçare.

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Autizmi është një çrregullim neurobiologjik kompleks e shumëplanësh i zhvillimit të njeriut. Këto çrregullime pra shkaktojnë dëmtime të komunikimit verbal, të aftësive dhe integritetit social. Pra Autizmi gjithashtu mund të bëjë njerëzit të shkojnë drejt izolimit social.

Autizmi është një çrregullim që prek njerëzit pa marrë parasysh gjinin apo racen. Ky studim do të tregojë se çfarë në të vërtetë është autizmi, dhe si ndikon ai tek personat që janë të prekur.

Autizmi kohëve të fundit apo më mirë të themi viteve të fundit ka nisur të njihet pakëz më shumë si dhe të flitet për të, duke u paraqitur si një shqetësim i madh i cili shkakton e fundit është përhapur më shumë dhe ka prekur numër të madh të njerëz.

Njerëzit të cilët janë të prekur nga ky çrregullim nuk janë në gjendje të tregojnë qartë se ky çrregullim nuk është një sëmundje apo të flasim e të sqarojmë qartë kompleksitetin e saj, andaj e gjithë kjo mbetet tek personat të cilët janë përgjegjës për ta, qoftë ata prindërit apo kujdestarët.

Ajo çfarë është më e vështirë të kuptohet dhe të dihet është që personat me autizëm duhet të marrin trajtim të veçantë psikik.

Duke marrë parasysh që fëmijët me autizëm nuk ndonjë ndryshim fizik, ky çrregullim prap se prap ndikon aq shumë në jetën komplet të personit të prekur, edhe si detyrë kryesore është integrimi i tyre nga shoqëria, në mënyrë që ata të bashkëpunojnë, punojnë së bashku kështu për të arritur sado pak socializim i tyre.

Autizmi ndikon në gjithë familjen e personit të prekur andaj secila familje si fillim kur planifikon krijimin e familjes, pastaj njohjes me fëmijën autik të jetë shumë i përgaditur për të luftuar bashkë çdo sfidë të cilët kalojnë këta persona.

3.1 Qëllimi i punimit

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të tërheqë vëmendjen e njerzëve se autizmi nuk është një sëmundje aq më pak ngjithëse por një çrregullim që mund të prek këdo, po ashtu të shqyrtojë shkaqet si dhe faktorët e rrezikut.

Me anë të këtij hulumtimi po ashtu do mundohemi të bëjmë ndërgjegjësimin e popullatës që ky çrregullim nuk është sëmundje, edhe se personat që janë të prekur nga kjo nuk mbartin në vetë asnjë lloj faji.

Në anën tjerët ndër qëllimet po ashtu i një rëndësie edhe më të madhe është për faktin që ne si staf infermieror duhet të dimë qartë edhe të njohim mir cdo lloj çrregullimi në mënyrë që të trajtojmë sa më mir cdo person në nevojë.

3.2 Objektivi i hulumtimit

Synimet apo objektivate këtij hulumtimi janë:

1. Të njihet qartë se çka është autizmi?
2. Të identifikohen faktorët që favorizojnë fillimin e këtij çrregullimi.
3. Të identifikohen cilat janë pasojat si dhe cilat janë llojet e autizmit.
4. Të evidentohen cilat janë nevojat e këtyre personave të prekur me këtë çrregullim.
5. Të evidentohen cilat janë kushtet dhe mënyrat e përkujdesjes ndaj fëmijëve me autizëm.
6. Të identifikohen cilat janë detyrat e Infermiereve si dhe cili është roli i tyre në raport me këtë çrregullim.

4. METODOLOGJIA

Ky hulumtim është i llojit cilësor, target i këtij hulumtimi janë fëmijët më autizëm nga mosha 0 vjeçare deri në moshën 18 vjeçare.

Gjatë këtij punimi si fillim është përdorur metoda përshkruese, pastaj ajo hulumtuese si pjesa kryesore e punimit, si dhe intervistë e drejtëpërdrejtë.

Është zhvilluar një intervistë me një doktor nga Qendra e Mjekësis Familjare (2) në Ferizaj, i cili është në kontakt të drejtëpërdrejtë më fëmijët autik, ku kemi marrë më shumë informacione, si dhe kordinatoren e Qendrës Pema po ashtu në Ferizaj, ku morëm informacione mbi numrin e saktë të personave autik në vendin tonë.

Të dhënat për autizmin janë marrë nga libra të ndryshme dhe webfaqe të internetit.

5. REZULTATET

➤ STUDIM RASTI

(Raste të disa fëmijëve autik në qendrën ditore “Pema”)

Gjatë hulumtimit tim pata rastin në shoh edhe nga afër punën e njëjës nga qendrat ditore në Ferizaj ,në qendër ofroreshin shërbime për fëmijët të cilët kishin nevojë të caktuara ndër ta edhe ata me autizem, në momentin kur është bërë hulumtimi në qendër merrnin trajtim gjithsej 6 fëmijë me autizem të cilët ishin nga qyteti i Ferizaj dhe rrethinës, tre nga ta ishin vajza dhe tre djemë, të moshës 5- 11 vjeç , po ashtu sipas statistikave që kam marrë në qendër 13 gjithësej kanë marrë shërbime po që jo të gjithë kanë vijuar të jenë të rregullt aty.

Në këtë qendër ditore trajtimi i këtyre fëmijëve është pa pagesë dhe këto shërbime ofrohen për të gjithë pa asnjë dallim. Seancat për fëmijë me autizem zgjanin 45 minuta, përfshirë këtu kryesisht lojra të ndryshme.

Rast në qendër: Vajzë 6 vjeçare ,gjatë seancë fëmija në fjalë kryesisht ishte e qetë, dhe nuk ipengonte prezencën e personave përreth, ajo kishte (Ehoralia)përsëritjen e fjalëve dhe kohë pas kohe kishte të qeshura. Gjatë kësaj seance gjithsej u zhvilluan katër lojëra, ku kërkohesh angazhimi i fëmijës dhe ndërkohë i bëhej edhe pyetje që të ushtrohej edhe ana e komunikimit verbal. Për stimulim në këtë rast është përdorur ushqimi, duke i treguar fëmijës që pas lojës ata do të kalojnë në pjesën e ngrënjes së ushqimeve. Fëmija në fjalë kishte edhe sjellje repetitive, levizje të duarve të pa kontrolluar kur nuk arrinte qëllimin për dicka të caktuar apo nuk mund të shqiptonte ndonjë fjalë dhe pas kësaj kishte këto sjellje. Po ashtu kohë pas kohe gjuante lehtëkokën e saj kur ju krijohej pa siguri gjatë aktivitetit. Përkundër të gjitha këtyre ajo dëgjontë udhëzimet e psikologes kur ajo përdorte një tonndryshe nga ai që ishte mësuar gjatë lojës.

Rasti tjetër në qendër : ishte po ashtu vajzë 11 vjeçare, sipas tomës në këtë rast lirisht mund të themi se ishin shumë më të rënda se rasti i parë për shkak se këtu mungonte total komunikimi verbal, pra ana e komunikimit ishte e prekur shumë rëndë, pavarësisht kësaj vajza shkoi në shkollë normale vetëm tri herë në javë pasi ndër problemet ishte edhe socializimi i saj , për këtë arsye dhe terapia e saj zhvillohej në dhomë multisenzorike, pasi për të ishte shumë më e vështirë të mësoj diçka kur është në prani të të tjerëve, ndërsa për ta stimular fëmijën në këtë rast është përdorur metoda shpërblyese. Kjo vajzë në këtë qendër kishte 4 vite që sjellej nga prindërit e saj një herë në javë dhe sipas psikologes aty ka shumë pak ndryshime dhe përparime nga ana e saj nga koha kur ka ardhur

sado që terapia dhe trajtimi i është ofruar korrektësisht. Në këtë rast ishte edhe e pamundur të merrja më shumë informacione për shkak të gjendjes së rëndë të vajzës.

Pra nga të dy raste mund lehtë të vërejmë simptomat të cilat i kemi përmendur në kapitujt më lartë ,atë të përsëritjeve të fjalive, mungesës se komunikimit verbal, pastaj mos socializimin.Në rastin e parë patëm fëmijën i cili nuk e kishte të prekur shumë anën e komunikimit si dhe ishte në gjendje të bënte dallime bazike,si dhe ishte e afët të përsëriste fjalit e psikologes. Ndërsa fëmija në rastin e dytë, përgjithësisht kishte gjendjen më të rëndë, të prekur rëndë total anën e të folurit gjë që i shkaktonte nervozizëm dhe mos stabilitet.

6. DISKUTIME DHE KONKLUSIONE

FËMIJËT AUTIK PËRBALL PROBLEMEVE SHËNDETËSORE

Fëmijët autik janë po të njëjtë si ne vetëm se sjelljet e tyre janë më të veçanta, dhe se kjo nuk përmban asnjë dallim në atë se çfarë problem shëndetësore mund të kenë këta fëmijë apo të sëmuren nga ndonjë sëmundje tjetër.

Gjatë një intervistë të cilën kam zhvilluar në qendrën emjekësis familjare (QMF 2) me doktor Ylber Murati i cili tregoni përvojat e tij me pacientët të cilët janë të prekur nga autizmi, tha se mund ti numëroj shumë pak raste të cilët ju janë drejtuar qendrës për ndonjë shqetësim, pors fillim dhe duke parashtruar problemin që në Kosovë ende familjet nuk flasin haptas për fëmijët e tyre dhe nuk i sjellin për trajtim, sipas tij fëmijët autik nuk duhet të mbahen fshehurazi pasi kjo nuk është diçka për të cilën familja duhet të ndihet e turpëruar apo në faj, dhe se ajo nuk është një sëmundje as ngjitëse e as nuk shkakton probleme apo jo siguri tek të tjerët.

Ne anën tjetër është diskutuar për problemet dhe shqetësimet për të cilat kenë më së shumti këta fëmijë se sipas doktorit fëmijët autik sëmuren si të gjithë fëmijët e tjerë të cilët nuk kanë ndonjë çrregullim specifik, ata sëmuren nga gripet dhe inflamacionet tjera si të gjithë personat e tjerë, dhe se gjatë ekzaminimit të fëmijët autikata trajtohet njësoj, as duke i mëshiruar po as duke i favorizuar por njësoj si të tjerët.

Por duhet të kemi parasysh që mund të jenë edhe një sërë gjendjesh fizike dhe mendore që shpesh mund të shoqërojnë autizmin.

Nga më të shpeshta janë:

- Problemet gastrointestinale (GI)
- Epilepsia- prek deri në një të tretën e personave me autizëm.
- Ankth
- Depresion
- Diçrregullimi i deficitit të vëmendjes / hiperaktivitetit (ADHD).

Mirpo kështu fëmijët autik paraqesin edhe shqetësime të tjera për trajtimin e tyre po ashtu përdoren edhe disa medikamente Kryesishtë ekzistojnë tre grupe të ilaçeve që konsiderohen të përshtatshme

për autizmin, ato që përdoren për të trajtuar simptoma të ADHD-së, antidepressivë (ilaçe kundër ankthit) si dhe medikamente atipike anti-psikotike.⁵

Doktori po ashtu tregoj që për shkak të mungesës së një listimi të pacientëve në Kosovë“një mjek për 2000 banorë “ ende është e vështirë detektimi i të gjitha rasteve të personave me nevoja të veqanta, konkretisht me autizem.

Ofrimi i ndihmës për këta fëmijë si nga doktorët po ashtu si dhe stafi infermieror duhet të jetë në nivelin sa më profesional të mundshëm për shkakun se është një kategori për të cilën duhe të kemi shumë informacione para se të veprojmë qoftë me ndonjë terapi, apo qoftë vetëm këshillim. *Kryesisht roli i një infermiere tek të prekurit me autizem është edukimi. Edukimi i prindërve dhe gjithë familjes për qasjen ndaj autikut dhe më gjërë.*

Fushat të rëndësishme të edukimit përfshijnë simptomat, mundësit e trajtimi, rezultate të pritura dhe të mundshme dhe burime mbështetëse. Prandaj, roli i infermierit si edukatore është thelbësor për një rezultat sa më pozitiv.

Duke pasur parasysh që vizitat shëndetësore janë shumë stresuese për personin me ASD, për shkak të mjediseve të panjohura dhe të reja të ndryshme nga rutina e tyre, infermieret duhet të jenë ato të cilat do të mundohen të lehtësojnë ankthin duke siguruar një ambientë të sigurt sa të këndshëm aq edhe të qetë për fëmijët autik.

Por pavarësisht çdo problemi shoqërues të cilin mund ta ketë edhe çdo person i cili nuk është fare i diagnostifikuar me autizem, autizmi nuk duhet konsideruar asnjëherë si një sëmundje , por një çrregullim i cili fatkeqësisht nuk mund të shërohet por mund të trajtohet shumë mir dhe të arrihen përmirësime të dukshme.

6.1 Përfundimi

Në këtë hulumtim kemi pasur mundësin të mësojmë mbi autizmin, se çfarë është në të vërtet, se si mund ta luftojmë sa do pak, dhe pse preken këta persona po ashtu gjatë hulumtimit jemi njohur edhe me disa raste të disa fëmijëve të prekur me autizëm ku kemi mundur të kuptojm më qartë se nga cka vujanë konkretisht këta fëmijë, po ashtu kemi bërë edhe dallime mestw dy rasteve ku njëri rezultoi të jetë i prekur shumë rëndë, ndërsa tjetëri kishe simptoma më të lehta.

<https://www.additudemag.com/autism-medication-treatment-help-parenting/>
<http://vikaspedia.in/health/mental-health/autism-1/role-of-nursing-care-for-children-with-autism>

Ajo çfarë kam konsideruar te nevojshme është rritja e numrit të personave që janë të specializuar për këtë fushë të cilët do të merreshin me autikët, të cilët do të kishin njohuri të shumta rreth trajtimit dhe diagnostifikimit të tyre, pasi është parë që një gjë e tillë mungon shumë në Kosovë, dhe se në qendrat ku kam vizituar ka pasu mungesë të tyre, kjo duke ju paraqitur problem dhe sfida më të vështira edhe gjatë punës.

Faktor tjetër po aq i rëndësishëm ka dal të jetë edhe trajtimi i këtyre personave nga shoqëria, pasi paragjykimet e shumta dalin të jenë ende shumë dominuese sidomos tek ne, duke mos i pranur në shoqëri si të gjithë njerëzit e tjerë, kjo pastaj ka ndikuar duke ia larguar të drejtën për tu shkolluar dhe për të pasur një jetë normale, si dhe për të punësuar në të ardhmen. Andaj është më se e domosdoshme që shoqëria të informohet sa më shumë për këtë kategori, ndaj si shoqata njashtu dhe institucionet qeveritare, dhe media duhet të bëjnë shumë më shumë për personat autik në senzibilizimin e shoqërisë për një jetë ku secili individë ka të drejtat e barabarta.

Mbështetja e fëmijëve me autizëm duhet të vazhdojësi nga familja ashtu dhe nga shoqëria pasi vetëm kështu mund të arrihet një mireqenje për të gjithë. Pra roli i familjes të cilët kanë ,një fëmijë të tillë del të jetë kryesori nga të gjithë, mbështetja, dashuria si dhe mirëkuptimi janë ato të cilat cdo fëmijë ka nevojë më së shumti.

Gjithashtu nga ky hulumtim u arrit në përfundim se autizmi nuk është sëmundje por është një crregullimi i zhvillimit, përveq kësaj u dhanë fakte rreth autizmit dhe simptomat e para që një fëmijë mund ti ketë, sepse edhe përtej mureve ka shpresë.

PA ASNJË DYSHIM “AUTIZMI ËSHTË VECANTI, JO KUFIZIM”.

7.REFERNCAT

1. SPIRO, S (2017), Autizmi, Tirane, Argeta LMG
2. EDLIRA, S (2018), Progres, Sfida e Autizmit, Tirane, Dita Print (2018)
3. MERRIAM, W. (2017) <http://www.learnersdictionary.com/definition/autism>
4. Fondacioni Fëmijëve Shqiptarë, <https://www.albanianchildren.org/qendra-e-autizmit-farke-2/cfare-eshte-autizmi/>
5. Nacional Autistic Society ,(London) <https://www.autism.org.uk/about/what-is/asd.aspx>
6. News Medical Life Sciences <https://www.news-medical.net/health/Autism-History.aspx>
7. Autizmi, <http://www.autizmi-ks.net/>
8. Autism Society <https://www.autism-society.org/>
9. US Department of Health and Human Services
<https://www.nichd.nih.gov/health/topics/autism/conditioninfo/causes>
10. Autism Speaks <https://www.autismspeaks.org/what-causes-autism>
11. HealthLine <https://www.healthline.com/health/asperger-syndrome>
12. JUDY ENDOW ,<http://www.judyendow.com/autistic-behavior/autism-and-consequences/>
13. AutismSpectrumDisorders <https://www.helpguide.org/articles/autism-learning-disabilities/autism-spectrum-disorders.htm>
14. SolidarSuisseKosovo <https://solidar-suisse-kos.org/wp-content/uploads/2019/01/shkarko1.pdf>
15. Very Well Health <https://www.verywellhealth.com/autism-treatment-4014208>
16. Additude-InsidetheADHD mind <https://www.additudemag.com/autism-medication-treatment-help-parenting/>
17. RoleofNursinginAutism <http://vikaspedia.in/health/mental-health/autism-1/role-of-nursing-care-for-children-with-autism>